



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Prishtinë/Priština, rr./ul. Agim Ramadani tel. +381 (0) 38 551 679; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Teksti zyrtar siç është amendamentuar me 11.11.2010

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,

Në bazë të nenit 15, 23 dhe 64.2, (a) dhe (b) të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe nenit 13, 14 dhe 20 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nxjerr:

RREGULLËN ZGJEDHORE Nr. 08/2009
CERTIFIKIMI I SUBJEKTEVE POLITIKE DHE I KANDIDATËVE TË TYRE

Neni 1
Përkufizimet

- (a) “Subjekt i certifikuar politik” do të thotë subjekti politik, qe është partia politike, koalicioni i partive politike, nisma qytetare ose kandidati i pavarur, i cili është i certifikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në përputhje me këto ligje dhe me rregullat e KQZ-së;
- (b) “Zgjedhje” do të thotë zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, zgjedhjet e Kuvendeve të Komunale dhe Kryetarëve të Komunave në Kosovë..
- (c) “Zgjedhje të Përgjithshme” do të thotë zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës.
- (d) “Zgjedhjet Komunale” do të thotë zgjedhjet për Kuvendin Komunal dhe zgjedhjet për Kryetar të Komunave në komuna të caktuara.
- (e) “Kandidat i pavarur” do te thotë kandidati për deputet të Kuvendit të Kosovës, kandidati për deputet të Kuvendit të Komunës, apo për Kryetar të Komunës, i cili nuk i takon asnjë partie politike ose nisme qytetare dhe nuk garon në emër të asnjë subjekti tjetër politik.
- (f) Koalicion do të thotë marrëveshja e dy ose me shume subjekteve politike
- (g) “KKZ” do të thotë Komisioni Komunal i Zgjedhjeve, që është organ përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve zgjedhore brenda territorit të komunës.
- (h) “PZAP” do të thotë Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, një organ i pavarur përgjegjës për vendosjen për parashtresat dhe ankesat në lidhje me procesin zgjedhor.
- (i) “Nisma Qytetare” do të thotë grupi i personave të cilët bashkohen vullnetarisht mbi bazën e një ideje, interesi ose pikëpamje të përbashkët, me qëllim zgjedhjen e kandidatëve të tyre, por që nuk dëshirojnë të formojnë parti politike;

- (j) “Përfaqësuesi financiar” do të thotë personi që është personalisht përgjegjës për mbajtjen e shënimeve financiare të subjektit politik, duke siguruar pajtueshmërinë e subjektit me këtë ligj dhe duke komunikuar me Zyrën e KQZ-së –lidhur me raportet për deklarimin e financave të fushatës së subjektit;

Neni 2

Dispozitat e përgjithshme

2.1 Subjekti politik me qëllim të pjesëmarrjes në zgjedhje për Kuvendin e Kosovës, në Zgjedhje Komunale ose për Kryetar Komunave, duhet të aplikojë pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Një subjekt politik që ka aplikuar për certifikim duhet të ja dorëzoj Zyrës listën e kandidatëve për certifikim.

2.2 Subjekti politik duhet të dorëzojë vetëm një kërkesë për certifikim për secilin nivel të zgjedhjeve (Kuvendin e Kosovës, zgjedhjet e Kuvendeve të Komunave dhe Kryetarëve të Komunave) në Zyre ose përmes KKZ-së përkatëse.

2.3 Partia politike e regjistruar është automatikisht e certifikuar, por duhet të njoftojë Zyrën brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga deklarimi i datës së zgjedhjeve nga Presidenti i Kosovës për çfarëdo ndryshimi për kryetar të partisë, përfaqësuesit të autorizuar të partisë, përfaqësuesit financiar të partisë dhe çfarëdo informata të nevojshme të kërkuara nga zyra për procesin e certifikimit. Pas përmbushjes së këtyre kërkesave partia politike e regjistruar do të jetë automatikisht e certifikuar përveç nëse PZAP-i konfirmon se një parti politike nuk i ka paguar gjatë dhe shqiptuara në zgjedhjet paraprake apo ndonjë detyrim tjetër përfshirë këtu edhe tarifën administrative të shqiptuara nga KQZ-ja.

2.4 Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga shpallja e datës së zgjedhjeve nga Presidenti i Kosovës, partia politike e regjistruar e cila nuk dëshiron të certifikohet për zgjedhje duhet të njoftojë Zyrën që nuk garon në zgjedhje, apo që partia politike do të kërkojë certifikim përmes koalicionit në përputhje me ligjin.

2.5 Koalicioni mund të certifikohet për të garuar në zgjedhje nën një emër, me kusht që përbëhet vetëm nga partitë politike që kanë të drejtë për tu certifikuar. KQZ-ja e trajton koalicionin si një subjekt politik të vetëm nga dita kur koalicioni është certifikuar deri në certifikim e rezultateve të zgjedhjeve. Partia politike nuk mund të tërhiqet nga koalicioni pasi të jetë certifikuar deri sa rezultatet e zgjedhjeve të certifikohen. Anëtarë e koalicionit janë përgjegjës për ndarjen e të gjitha obligimeve dhe borxheve të shkaktuara.

2.6 KQZ-ja e trajton nismën qytetare si subjekt politik nga dita e certifikimit të saj deri sa nisma qytetare të dorëzojë raportin përfundimtar të Publikimit Financiar të Fushatës. Secili kandidat i certifikuar në listën e nismës qytetare është personalisht përgjegjës për ndarje të barabartë të gjatë të ngarkuar mbi nismën qytetare nga KQZ-ja apo PZAP-i

2.7 Kandidati i pavarur mund të certifikohet për pjesëmarrje në zgjedhje, me kusht që ai ose ajo ka të drejtë të jetë kandidat sipas nenit 29 të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe është i/e regjistruar për të votuar. Kandidati i pavarur nuk mund, që në të njëjtat zgjedhje të kërkojë certifikimin si kandidat për një parti politike, koalicion apo nismë qytetare. Kandidati i pavarur nuk mund të tërheqë kandidaturën e tij apo saj para certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.

2.8 Çdo dështim në përmbushjen e kërkesave të këtij rregulle dhe legjislacionit të aplikueshëm i jep të drejtë KQZ-së të pezullojë procesin e aplikimit. Përveç këtyre kërkesave për certifikimit KQZ-ja me pranimin e aplikimit për certifikim nga subjekti politik, kërkon nga PZAP-i të japë konfirmim me shkrim se subjekti politik që aplikon ka paguar plotësisht gjokat në lidhje me zgjedhje të mëparshme dhe të konfirmojë se nuk ka borxhe tjera të papaguara. KQZ-ja mund të pezullojë procesin e aplikimit nëse Partia politike nuk ka paguar gjokat ose tarifat administrative të shqiptuara nga KQZ-ja.

2.9 E gjithë korrespondenca zyrtare Zyre/KQZ në të shkruar me subjektet politike bëhet përmes Personit Kontaktues dhe kutisë postare të Subjektit politik në pajtueshmëri me rregullën zgjedhore 05/2008 mbi Kutitë Postare të Subjekteve politike.

Neni 3

Aplikimi për certifikim i Subjektit Politik

3.1 Subjekti politik që synon të garoj në Zgjedhje për Kuvendin e Kosovës, Kuvende komunale dhe Kryetarë të Komunave duhet të aplikoj për certifikim në Komisionin Qendror Zgjedhor (KQZ). Subjekti politik duhet të dorëzojë dokumentacion në Zyre ose në KKZ-në përkatëse të asaj komune në çdo kohë gjatë orëve të rregullta të punës jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë para zgjedhjeve dhe ditës së zgjedhjeve.

3.2 Secili aplikim për certifikim të subjektit politik duhet të shoqërohet me të gjithë dokumentacionin e mbështetur të kërkuar si në vijim që përmban informatat e më poshtme dhe formularin e plotësuar të kërkesës për certifikimin të subjektit politik, i cili është bashkëngjitur si Shtojca (1), i cili përmban:

- a) emrin dhe akronimin e subjektit politik, ashtu siç dëshiron të figuroj në fletëvotim;
- b) zgjedhjet në të cilat subjekti politik konkurren dhe në cilat komunat
- c) certifikatën e Regjistrimit (numri personal në rastin e kandidatëve individual)
- d) emri, mbiemri, adresa dhe numri i telefonit të kryetarit të subjektit politik ku kjo është e zbatueshme, dhe përfaqësuesit të autorizuar dhe numri i telefonit të zyrës qendrore të subjektit politik
- e) kopja e shenjës së partisë, apo në rast koalicionesh, kopja e shenjës e të gjitha partive politike që janë në koalicion dhe çfarëdo shenje të vetë koalicionit
- f) emri, mbiemri, adresa dhe numri i telefonit i zyrtarit financiar të subjektit
- g) emri, mbiemri, adresa dhe numri i telefonit i personit të ngarkuar me procesin zgjedhor në emër të subjektit
- h) deklaratat e nënshkruar nga kryetari i partisë, apo bartësi i listës për subjekte të tjera që zotohen për të respektuar dhe vepruar në përputhje me Kodin e Mirësjelljes gjithashtu edhe çdo Subjekt Politik duhet që në aplikimin e tij për certifikimit, të marrë përsipër dhe të nënshkruaj se do respektoj Kodin e Mirësjelljes.

- i) deklarata politike, e cila nuk tejkalon 150 fjalë, dhe në gjuhën apo gjuhët e zgjedhjes së saj, për qëllim të shpërndarjes së votuesve pjesëmarrës në zgjedhje si votues jashtë Kosovës. Deklarata politike është në përputhje me Kodin e Mirësjelljes dhe të nënshkruar nga kryetari apo nënshkruesi i autorizuar i subjektin politik
- j) nëse subjekti politik është koalicion, deklaratën e nënshkruar si Shtojca (3) nga kryetari i secilës parti politike të regjistruar e cila merr pjesë në koalicionin përmes së cilës jepet pëlqimi për të marrë pjesë, duke bërë me dije mënyrën përmes së cilës kandidatët do të radhiten në fletëvotim në mesin e anëtarëve të koalicionit, dhe që zotohen për të respektuar dhe vepruar në pajtim me Kodin e Mirësjelljes
- k) në rastin e nismës qytetare, numrin e letërnjoftimit të udhëheqësit të nismës, përfaqësuesin e autorizuar dhe përfaqësuesin financiar të autorizuar. Në rast të kandidatit të pavarur apo nismës qytetare, kandidati apo udhëheqësi i nismës po ashtu mund të shërbejë si përfaqësues i autorizuar dhe përfaqësues financiar
- l) subjekti politik në aplikimin e tij tregon nëse dëshiron të hyjë në garë për Kuvendin e Kosovës për të fituar ndonjërin prej vendeve të rezervuara për përfaqësim të serbëve dhe komuniteteve tjera jo shumicë të Kosovës.

3.3 Subjektet Politike qe se paku ne zgjedhjet e fundit të të njëjtit nivel kane marre një ulëse, lirohet nga pagesa e depozitit.

3.4 Çdo Subjekt politik aplikimin e tij për certifikim duhet të përfshijë librezat e nënshkrimeve, në formularin i cili është bashkëngjitur si Shtojca (2), përmbajnë:

- a) njëqind (100) nënshkrime të përkrahjes të votuesve të regjistruar për secilën zgjedhje komunale në të cilën subjekti politik ka për qëllim të konkurrojë, por jo më shumë se njëmijë (1000) nënshkrime nëse ka për qëllim të konkurrojë në dhjetë (10) ose më shumë zgjedhje komunale, dhe
- b) njëmijë (1000) nënshkrime të vlefshme nëse ka për qëllim të konkurrojë në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës; dhe

3.5 Personi mund të japë nënshkrimin e tij/saj në mbështetje të vetëm një subjekti politik për ato zgjedhje.

3.6 Llojet e nënshkrimeve në vijim konsiderohen sit ë pavlefshme dhe nuk llogariten ndaj kërkesës së nënshkrimeve të përcaktuara në nenin 3.3

- a) nënshkrimet e personave të cilët nuk janë votues të regjistruar;
- b) nënshkrimet e mbështetjes për të cilat çfarëdo informate e kërkuar mungon apo është e pa lexueshme;
- c) nënshkrimet të cilat janë me të njëjtin dorëshkrim si nënshkrimet tjera, përfshirë nënshkrimet nga udhëheqësi i familjes për anëtarët e tjerë të familjes; dhe
- d) nënshkrimet të cilat përfshijnë informata të cilat nuk përputhen me informatat e regjistruara në variantin më të fundit të listës së votuesve

- e) nënshkrimet e personave të cilët tanimë kanë nënshkruar në përkrahje të një subjekti tjetër politik

3.7 Secili aplikim për certifikim përfshinë numrin e nevojshëm të nënshkrimeve përveç nëse subjekti politik (Koalicioni, Iniciativa qytetare dhe Kandidati i pavarur) ka marrë së paku një (1) ulëse në zgjedhjet e fundit të llojit të njëjtë nuk kërkohet të dorëzojë nënshkrimet në mbështetje të aplikimit të saj për certifikim në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës apo nëse ka për qëllim të konkurrojë në zgjedhje komunale në komunën ku subjekti politik ka fituar së paku një vend në zgjedhjet e mëparshme për kuvendet komunale.

3.8 Dëftesën bankare të depozitit që tregon se subjekti politik që ka aplikuar për t'u certifikuar, e ka paguar depozitën e certifikimit prej:

- i. dyqind (200) eurosh për secilën zgjedhje komunale që ka për qëllim të konkurrojë; ose
- ii. dymijë (2000) euro nëse ka për qëllim të konkurrojë në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, deri në më së shumti dymijë (2000) euro nëse ka për qëllim të konkurrojë në të dy zgjedhjet, në ato komunale dhe për Kuvendin e Kosovës;

Neni 4

Shqyrtimi i aplikacioneve për certifikim të Subjekteve Politike

4.1 Pas marrjes së kërkesës për certifikim nga subjekti politik, Zyra ose ZKZ-ja, sipas rastit, duhet të pranojë dokumentacionin në prani të përfaqësuesit të subjektit politik, dhe:

(a) e pranon aplikimin për certifikim dhe ia jep dëftesën përfaqësuesit të subjektit politik, me të cilën tregohet data e dorëzimit;

(b) ia kthen subjektit politik kërkesën për certifikim nëse dokumentacioni nuk është i plotë ose nëse nuk është në përputhje me kërkesat e parapara në nenin 3, dhe i shpjegohet subjektit politik pse dokumentacioni është i pakompletuar.

4.2 Zyra duhet ta shqyrtojë secilën kërkesë për certifikim dhe të konstatojë nëse:

- (a) formulari i aplikimit të kërkesës për certifikim të subjektit politik është plotësuar saktë dhe në mënyrë të plotë;
- (b) dokumentacioni përcjellës është i plotë dhe se nënshkrimet në librezën e nënshkrimeve janë të vlefshme dhe të mjaftueshme.

4.3 Zyra i shqyrton të gjitha aplikimet për certifikim dhe nëse përcakton se subjekti politik nuk ka plotësuar të gjitha kërkesat atëherë Zyra brenda dhjetë (10) ditëve pas pranimit të aplikimit për certifikim dërgon një njoftim me të cilin e informon subjektin politik për arsyen pse aplikimi nuk është i mjaftueshëm.

4.4 Aplikuesi i cili pranon njoftimin nga Zyra, siç përcaktohet në nenin 4.3 ka pesë (5) ditë pune për të dorëzuar aplikimin e korrigjuar apo një shpjegim që adreson brengat e identifikuara në njoftim, në Zyrë apo te ZKZ-ja.

4.5 Pasi subjekti politik e dorëzon aplikacionin e kërkesës së tij të korrigjuar për certifikim si përshkruhet në nenin 4.4, Zyra i bën rekomandim me shkrim KQZ-së për ta miratuar ose refuzua aplikimin brenda pesë (5) ditëve nga pranimi i dokumentacionit të plotë.

4.6 Pas pranimit të rekomandimit nga Zyra, KQZ-ja e miraton ose refuzon aplikimin për certifikim brenda (7) ditëve të punës.

4.7 Pas vendimit të KQZ-së, Zyra e njofton menjëherë aplikuesin me shkrim rreth statusit të aplikimit dhe në rast të refuzimit, ofron arsytimin për refuzim dhe e këshillon aplikuesin për të drejtën e tij për tu ankuar në PZAP brenda pesë (5) ditëve

4.8 Zyra, në koordinim me ZKZ-të, duhet ta mbajë një ditar i cili përmban të gjitha kërkesat e marra për certifikim, datat e dorëzimit dhe të ri dorëzimit të ndryshimeve në ato kërkesa, nga secili subjekt politik.

Neni 5

Aplikimi për certifikim i kandidatëve

5.1 Subjektet politike që kanë aplikuar për certifikim për të marrë pjesë në zgjedhje duhet t'i dorëzojë Zyrës listën e kandidatëve, në formularin e bashkangjitur si shtojca 3, në çdo kohë gjatë orëve të rregullta të punës jo më vonë se (60) ditë para zgjedhjeve.

5.2 Aplikimi duhet të përfshijë:

- (a) listën e kandidatëve të subjektit politik për secilën zgjedhje në të cilën konkurrohet, e cila është bashkëngjitur si Shtojca (4), të shtypur dhe të nënshkruar nga kryetari i subjektit politik ose personi kontaktues, si edhe në formën elektronike siç përshkruhet në nenin 5.4.
- (b) formularin e certifikimit të kandidatit dhe formularin e publikimit financiar të kandidatit për secilin kandidat të përfshirë në secilën listë të kandidatëve, të cilat janë bashkëngjitur si Shtojca (5), përkatësisht Shtojca (6).

5.3 Secili kandidat duhet të plotësojë formularin e certifikimit të kandidatit, siç është parashtruar në nenin 5.2 (b), dhe ta nënshkruajë atë si konfirmim se:

- a) nuk mban asnjë post që do ta bënte atë të pamundur për t'u paraqitur si kandidat bazuar në nenin 29 të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës
- b) ai/ajo jep pëlqimin të paraqitet si kandidat për subjektin politik në listën e të cilit ai/ajo paraqitet;
- c) ai/ajo zotohet të veprojë në përputhje me Ligjet zgjedhore, Rregullat e zgjedhjeve të KQZ-së, dhe Kodin e sjelljes.

5.4 Subjekti politik po ashtu duhet të përgatisë një bazë elektronike të të dhënave që përmban si vijon:

- a) emrin, mbiemrin gjininë dhe datën e lindjes së të gjithë kandidatëve të tij;
- b) adresat e kandidatëve, ashtu siç figurojnë në Regjistrin Civil

- c) numrat e telefonave të kandidatëve, kur ka të tillë në dispozicion; dhe
- d) numrat personal të identifikimit

5.5 Kandidatët në listën e subjektit politik mundën të aplikojnë për zgjedhjet në të gjitha nivelet vetëm në emër të një subjekti politik

5.6 Në listën e kandidatëve të secilit subjekt politik së paku tridhjetë (30%) për qind janë meshkuj dhe së paku tridhjetë (30%) për qind janë femra: me nga një kandidat të secilës gjini përfshirë së paku njëherë në secilin grup prej tre kandidatëve e që numërohet nga kandidati i parë në listë. Kjo nuk aplikohet te listat e përbëra nga një apo dy kandidatë. Subjekti politik që nuk është kandidat i pavarur e paraqet listën e kandidatëve në përputhje me nenin 27, nenin 29 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe rregullat e KQZ-së.

5.7 Numri i emrave të dorëzuar në Listë të kandidatëve të një subjekti politik siç përcaktohet në nenin 5.2(a), nuk mund të përmbajë më shumë se 10% e maksimumit të numrit të ulëseve të caktuara në kuvendin për të cilin ka për qëllim të konkurrojë.

Neni 6

Shqyrtimi i aplikacioneve për certifikim të kandidatëve

6.1 Zyra duhet të shqyrtojë të gjithë dokumentacionin e pranuar;

- a) për secilin kandidat që paraqitet në listën e kandidatëve të subjektit politik është paraqitur formulari i certifikimit të kandidatit në përputhje me nenin 5 dhe;
- b) për secilin kandidat që paraqitet në listën e kandidatëve të subjektit politik është plotësuar si duhet formulari i publikimit financiar të kandidatit dhe i nënshkruar nga kandidati

6.2 Zyra duhet ta shqyrtojë secilën kërkesë për certifikim dhe të konstatojë nëse të gjithë kandidatët që paraqiten në listën e kandidatëve:

- a) janë votues me zotësi juridike nëse konkurrojnë në zgjedhje për Kuvendin e Kosovës; ose
- b) janë votues me zotësi juridike të regjistruar në komunën në të cilën kanë për qëllim të konkurrojnë për zgjedhjet komunale;
- c) janë votues me zotësi juridike nëse konkurrojnë për kryetare komune dhe së paku tre (3) vite duhet me qenë banor i komunës në të cilën ai apo ajo është duke garuar për tu zgjedhur si Kryetar Komune.
- d) përmbushin të gjitha kriteret të përcaktuara në nenin 29 të Ligjit Nr. 32/L-073 mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës
- e) të paraqitën në listën e kandidatëve të vetëm një subjekti politik

6.3 Zyra i shqyrton të gjitha listat e kandidatëve dhe, në rast të përfundimit se subjekti politik i është përgjigjur kërkesave atëherë i rekomandon KQZ-së certifikimin e listës brenda dhjetë (10) ditëve pas pranimit të listës nga Zyra.

6.4 Nëse Zyra vendos që lista e kandidatëve nuk përmbush dispozitën e mësipërme, e njofton subjektin politik që të korrigjojë listën e kandidatëve në periudhën brenda pesë (5) ditëve të punës, duke dhënë arsyetimin/et/ se përse lista e tyre duhet korrigjuar.

6.5 Subjekti politik i cili e pranon njoftimin e përcaktuar këtij neni i ka tre (3) ditë pune pas pranimit të njoftimit sipas nenit 6.5 për të dorëzuar aplikimin e korrigjuar ose një arsyetim që adreson shqetësimet në çështjet e identifikuar në njoftim, ose të dyja bashkë.

6.6 Zyra i paraqet rekomandimin me shkrim KQZ-së për ose kundër certifikimit të listës së kandidatëve brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas dorëzimit të njoftimit sipas nenit 6.4.

6.7 Zyra i bën një rekomandim të shkruar KQZ-së për ose kundër certifikimit të secilës liste të kandidatëve të pranuar jo më vonë se pesë (5) ditë pune pas afatit për dorëzim të listave.

6.8 Ankesa e cilitdo subjekt politik ndaj vendimit të KQZ-së për të refuzuar certifikimin e listës së kandidatëve duhet të dorëzohet tek PZAP-i bëhet brenda afatit prej pesë (5) ditë pune pas njoftimit të atij subjekti politik me vendimin.

6.9 KQZ-ja i publikon listat e certifikuar të kandidatëve në afat brenda pesë (5) ditëve pas certifikimit dhe secilin ndryshim në të brenda pesë (5) ditëve tjera shtesë.

Neni 7

Tërheqja apo Zëvendësimi i Kandidatëve dhe Subjekteve Politike

7.1 Subjekti politik i certifikuar mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor duke i dorëzuar KQZ- së një njoftim me shkrim me të cilin shpreh qartazi qëllimin për tërheqje jo më vonë se dy (2) ditë të punës para datës së caktuar për hedhje të shortit për zgjedhje. Nëse kandidati vdes para zgjedhjeve, subjekti i certifikuar politik mund ta zëvendësojë atë dy (2) ditë para datës së caktuar për tërheqjen e shortit.

7.2 Në rast se PZAP-i largon një kandidat nga lista e kandidatëve pas përcaktimit se kandidati nuk ka dhënë pëlqimin e tij apo saj për t'u emëruar si kandidat, subjekti politik nuk mund të zëvendësojë atë kandidat në listën e kandidatëve, por siguron që lista të jetë në përputhje me nenin 5.6 të kësaj rregulle.

7.3 Duke mos paragjykuar dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni, një subjekt politik, nismë qytetare apo koalicion mund që katër (4) ditë pas largimit të kandidatit, por jo më vonë se 2 ditë para certifikimit ta zëvendësojë atë nëse ai kandidat në të njëjtën kohë paraqitet në listën e kandidatëve të një tjetër subjekti politik, nismë qytetare ose koalicioni dhe shfaq synim të qartë të shkrim se do të mbetet në listën e subjektit tjetër politik.

7.4 Të gjitha kërkesat bazuar në nenin 29 të ligjit mbi zgjedhjet e përgjithshme për të tërhequr një kandidat të certifikuar nga zgjedhjet i dorëzohen në KQZ.

Neni 8

Ruajtja dhe Verifikimi i të Dhënave të Kandidatëve

8.1 Zyra do të mbajë në konfidencë të gjitha informacionet rreth kandidatëve të dorëzuara tek KQZ-ja në pajtueshmëri me rregullat dhe ligjet e aplikueshme, deri pas certifikimit të kandidatit

nga ana e KQZ-së, përveç rasteve kur Zyra do t'u ofrojë të gjitha agjencive për zbatimin e ligjit secilin informacion të nevojshëm për këto organizata me qëllim të sigurisë gjatë procesit të zgjedhjeve.

8.2 Pasi kandidati të jetë certifikuar, Zyra mund të publikojë të dhënat personale të atij personi vetëm siç lejohet me ligjin e aplikueshëm.

8.3 Në rast se KQZ-ja nuk certifikon një kandidat, Zyra nuk i zbulon të dhënat personale të atij kandidatit.

Neni 9 Pagesa e certifikimit

9.1 KQZ-ja do të hapë dhe mbajë një xhirologari bankare në emër të KQZ-së, e cila do të përdoret për grumbullimin dhe refundimin e pagesave të certifikimit . Detajet e xhirologarisë bankare janë në faturën e pagesës.

9.2 Nëse subjekti politik fiton së paku një (1) vend në zgjedhjet në të cilat konkurron, pagesa e certifikimit i refundohet subjektit politik brenda tridhjetë (30) ditësh pas datës së certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve. Refundimi i tillë bëhet në xhirologarinë bankare të deklaruar nga subjekti politik në kërkesën e tij për certifikim.

9.3 Depozitat e certifikimit të cilat nuk refundohen duhet t'i barten Buxhetin e Kosovës.

Neni 10 Renditja në Fletëvotim

10.1 Shorti i renditjes në fletëvotim mbahet në një datë të caktuar nga KQZ-ja mirëpo jo më vonë së dyzetepesë (45) ditë para datës së zgjedhjeve.

10.2 Kryetari i KQZ-së vendos për procedurat që duhen respektuar gjatë tërheqjes së shortit, duke siguruar se tërheqja është e drejtë dhe transparente, Kryetari i KQZ-së e kryeson tërheqjen e shortit.

10.3 Zyra i njofton subjektet politike për vendndodhjen, datën dhe kohën në të cilën shorti i renditjes në fletëvotim do të mbahet. Secili subjekt politik dërgon një përfaqësues për të tërhequr shortin dhe vëzhguar mbajtjen e shortit të fletëvotimit. Kryesuesi i KQZ-së kryeson lotarinë e fletëvotimit dhe nëse subjekti politik nuk e dërgon përfaqësuesin në shortin e fletëvotimit, një anëtar i KQZ-së sekretariatit e tërheq shortin për atë subjekt.

Neni 11 Hyrja në fuqi

Kjo Rregull e ndryshuar zëvendëson Rregullën e mëparshme mbi Certifikimin e Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të tyre dhe hyn në fuqi më 25.06.2009.

Nesrin Lushta

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
